

**GJYKATA E APELIT  
PRISHTINË**

---

**Numri i lëndës:** PAKR 215/14

**Data:** 14 maj 2015

**Gjykata Themelore:** Prishtinë, PKR 237/13

Originali: **Anglisht**

---

Gjykata e Apelit, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Radostin Petrov, kryetar i kolegjit dhe gjyqtar raportues, dhe gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Dr. Driton Muharremi e Tonka Berishaj si anëtarë të kolegjit, me asistimin e Dr. Bernd Franke, zyrtar ligjor i EULEX-it, i cili vepron në cilësinë e procesmbajtësit,

në lëndën lidhur me të pandehurin:

**Y.J., mashkull, emri i të atit [...], i lindur më [...] në [...], Gjermani, shqiptar i Kosovës, adresa e fundit e banimit në [...], Kosovë, aktualisht në [...];**

i akuzuar nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (ZPSRK) me aktakuzën PPS 42/2012, e ngritur më 11 prill 2013 për:

pesë (5) vepra penale të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike, në kundërshtim me nenin 229 paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të KPK-së lidhur me nenin 3 të KPK-së;

një (1) vepër penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, par. 2 të KPK-së,

dhe veprën penale të krimit të organizuar, në kundërshtim me nenin 274, par. 1, 2 dhe 3 të KPK-së;

i gjykuar në shkallën e parë nga Gjykata Themelore e Prishtinës me aktgjykimin PKR 237/13, të datës 29 nëntor 2013, me të cilin i pandehuri **Y.J.** u shpall fajtor dhe në përputhje me nenin 71 të KPK-së, u dënua me dënim unik prej njëmbëdhjetë (11) vjet burgim dhe gjobë në shumën prej 25,000 euro;

duke vendosur përkitazi me ankesat e parashtruara nga avokati mbrojtës Besnik Berisha më 3 mars 2014 dhe nga mbrojtësi Zivojin Jokanovic më 10 mars 2014, të dyja kundër aktgjyqimit PKR 237/13, të marrë nga Gjykata Themelore e Prishtinës më 29 nëntor 2013;

dhe pas shqyrtimit të ankesës së parashtruara nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (tash e tutje në tekst PSRK) më 24 mars 2014 kundër urdhëresës PKR 237/13, të nxjerrë nga Gjykata Themelore e Prishtinës më 6 mars 2014;

pas marrjes parasysh të përgjigjeve të PSRK-së, të parashtruara më 11 mars dhe 2 prill 2014 dhe përgjigjen e avokatit mbrojtës Ramë Gashi, të parashtruara më 26 mars 2014;

pas shqyrtimit të propozimit të prokurorit të apelit të shtetit, i parashtruar më 15 prill 2014,

pas mbajtjes së seancës së hapur të Gjykatës së Apelit më 29 prill 2015;

pas mbajtjes së këshillimit më 30 prill dhe 14 maj 2015, dhe votimit më 14 maj 2015;

duke vepruar në përputhje me nenet 389, 390, 394, 398 dhe 402 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP);

merr këtë:

---

## AKTVENDIM

---

- 1) **Pranohen** ankesat e mbrojtësit Besnik Berisha, e parashtruar më 3 mars 2014 dhe e mbrojtësit Zivojin Jokanovic, e parashtruar më 10 mars 2014 ndërsa **anulohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës, i lëshuar më 29 nëntor 2013, PKR. Nr. 237/2013.
- 2) **Pranohet** ankesa e prokurorit të PSRK-së, e parashtruar më 24 mars 2014 kundër urdhëresës PKR nr. 237/13 ndërsa **anulohet** urdhëresa PKR nr. 237/13, e datës 6 mars 2014.
- 3) Lënda **kthehet** në Gjykatën Themelore të Prishtinës në rigjykim.
- 4) I pandehuri mbetet në paraburgim sipas kushteve ligjore derisa Gjykata Themelore të marr vendimin e radhës. Gjykata Themelore duhet të vendos në përputhje me nenin 193 të KPP-së.

## ARSYETIMI

---

### I. HISTORIKU I GJERTANISHËM I PROCEDURËS

Zyra e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (ZPSRK) ka ngritur aktakuzën (PPS nr. 42/2013, të datës 9 prill 2013) më 11 prill 2013 kundër të pandehurit **Y.J.** duke e akuzuar për pesë (5) vepra penale të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike, në kundërshtim me nenin 229 paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të KPK-së lidhur me nenin 23 të KPK-së; një (1) veprë penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, par. 2 të KPK-së, dhe veprën penale të krimit të organizuar, në kundërshtim me nenin 274, par. 1, 2 dhe 3 të KPK-së;

Trupi gjykues i Gjykatës Themelore të Prishtinës më 29 nëntor 2013, e shpalli fajtor të pandehurin **Y.J.** për veprën penale të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike, në kundërshtim me nenin 229 paragrafët 1, 2, 3 të Kodit Penal të Kosovës (Kodi i vjetër Penal) dhe veprën penale të krimit të organizuar, në kundërshtim me nenin 274, par. 3 të KPK-së, dhe në përputhje me nenin 71 të KPK-së, u dënua me dënim unik prej njëmbëdhjetë (11) vjet burgim dhe gjobë në shumën prej 25,000 euro. Akuza për mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, par. 2 të KPK-së u refuzua në përputhshmëri me Ligjin për amnisti.

Aktgjykimi i shkruar i është dorëzuar të pandehurit më 20 shkurt 2014 dhe mbrojtësit Besnik Berisha më 14 shkurt 2014, mbrojtësit Zivojin Jokanovic më 21 shkurt 2014 dhe mbrojtësit Ramë Gashi më 13 shkurt 2014. Aktgjykimi i është dorëzuar prokurorit të PSRK-së më 11 shkurt 2014.

Trupi gjykues i Gjykatës Themelore të Prishtinës më 6 mars 2014, ka nxjerrë një urdhëresë për lirim e veturës Audi A 6, stoli të çmuara, 15 telefona celular, llaptop, orë Rolex dhe para të konfiskuara gjatë bastisjes më 2 tetor 2012, sikurse përshkruhen në aktakuzë, në përputhje me nenin 241, par. 1 nën-par. 1.9 të KPPK-së.

Në emër të të pandehurit, mbrojtësi Berisha ka parashtruar ankesë kundër aktgjykimit më 3 mars 2014. Mbrojtësi Zivojin Jokanovic ka parashtruar ankesë kundër aktgjykimit më 10 mars 2014, e arsyetuar më 24 mars 2014. Për më tepër, më 24 mars 2014, prokurori i PSRK-së ka parashtruar ankesë kundër urdhëresës për lirim e sendeve të konfiskuara, PKR Nr. 237/13.

Prokurori i PSRK-së ka parashtruar përgjigje ndaj ankesave të mbrojtësve (të parashtruara më 11 mars dhe 2 prill 2014) dhe mbrojtësi Ramë Gashi kundër ankesës së prokurorit (e ushtruar më 26 mars 2014).

Seanca e kolegjit të Gjykatës së Apelit u mbajt më 29 prill 2015 në praninë e të pandehurit, mbrojtësve të tij Besnik Berisha dhe Ramë Gashi si edhe prokurorit të apelit të shtetit.

Kolegji u këshillua më 30 prill dhe 14 maj 2015 ndërsa ka votuar më 14 maj 2015.

## II. PARASHTRESAT E PALËVE

### Ankesat kundër aktgjykimit

**Avokati mbrojtës Besnik Berisha** më 3 mars 2014 ka parashtruar ankesë me afat më 2 mars 2014 në Gjykatën Themelore, për shkak të:

- Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale;
- Vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike;
- Shkeljes së ligjit penal;
- Vendimit mbi dënimin.

Ai propozon që të pranohet ankesa, të ndryshohet aktgjykimi duke e shpallur të akuzuarin të pafajshëm dhe duke e liruar nga akuzat në bazë të nenit 364, par. (1), nënpar. (1) dhe (3) të KPP-së apo të anulohet aktgjykimi i kundërshtuar dhe të ridërgohet në rigjykim lënda në fjalë.

Ai deklaron se aktgjykimi i kontestuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në bazë të nenit 384 (1), nënpar. 1.8 të KPP-së, për shkak se bazohet në tërësi në prova të papranueshme, në mes tjerash edhe në deklaratat e personave M.G. dhe M.O. Në procedurën penale të kryer kundër tyre në Gjermani, të dytë M.G. dhe M.O. e përmendin emrin e **Y.J.**, por e gjithë kjo është bërë në një procedurë tjetër, kur ata janë marrë në pyetje në cilësinë e të akuzuarit. Në bazë të nenit 128, par. 1, nënpar. 1.4 të KPP-së, këta dëshmitarë janë marrë në pyetje në mënyrë tjetër, në procedura tjera dhe në kundërshtim me dispozitat e KPP-së. Gjykata e shkallës së parë është në kundërshtim të plotë me nenin 370, par. 7 të KPP-së, sepse aktgjykimit të kundërshtuar i mungojnë faktet e mjaftueshme vendimtare lidhur me rrethanat që **J.** ka qenë kryesori në grupin e organizuar kriminal në Gjermani, rrethana këto të shqyrtuara dhe tërësisht të bazuara vetëm në dëshminë e dëshmitarit T.A. Gjykata e shkallës së parë ia ka lejuar këtij dëshmitari që ta bëjë përmbledhjen dhe përshkrimin e dëshmive të personave tjerë ashtu siç kujtonte, të personave të akuzuar në Gjermani M.G. dhe M.O. Këto dëshmi ai i kishte dëgjuar në gjykimin në Gjermani. Dëshmitari A. po ashtu deklarohet edhe për identifikimin e të pandehurit, përkundër faktit se ai nuk e sqaron se si është bërë identifikimi në fjalë. Mbrojtja gjithashtu vëren se në këtë procedurë është shkelur edhe parimi i barazisë së palëve, sepse Gjykata Themelore e ka lejuar dhe i ka besuar në tërësi dëshmisë së hetuesit A., ndërsa nga ana e tjetër e refuzon

propozimin e mbrojtjes për ta dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit avokatin i cili nuk kishte marrë pjesë në procedurën penale kundër personit M.G. dhe personave tjerë.

Mbrojtësi pretendon se nga këndvështrimi ligjor, i pandehuri nuk ka mundur të shpallet fajtor dhe të dënohet për dy krime (edhe për veprën blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e substancave narkotike dhe psikotrope edhe për veprën krimi i organizuar), kur është vetëm një veprë. Ai vëren se kryerësi ka mundur të kryejë vetëm një veprë penale e jo dy vepra. Ai po ashtu vëren se vepra penale për të cilën **J.** është shpallur fajtor, nuk sanksionohet me burgim prej së paku katër vjet.

Aktgjykimi fajësues i shpallur nga Gjykata Themelore është përgatitur dhe bazuar në supozime, në dëshmi të dhëna në një procedurë tjetër, pa praninë e të akuzuarve, dhe në pjesën më të madhe në policin i cili e ka ndjekur penalisht rastin në Gjermani. E vetmja provë mbi të cilën gjykata është duke tentuar ta bazojë aktgjykimin e saj janë telefonatat dhe transkriptet e telefonatave të përgjuara, të cilat, edhe pas ekspertizës së kryer ende vazhdojnë të mbesin një dilemë e madhe sa i takon saktësisë dhe autencitetit të tyre.

Ai po ashtu thekson se droga e lokalizuar në banesë në rrugën [...] dhe droga e lokalizuar në shtëpinë në [...], e cila është krejtësisht për përdorim personal, në dozë jo më shumë se për tri – katër ditë, nuk ka mundësi të ketë qenë e destinuar për shpërndarje. Me asnjë provë nuk është vërtetuar se droga e konfiskuar nga ai nuk ka qenë për përdorim personal të tij por për shpërndarje.

Mbrojtja vëren se ky aktgjykim jo vetëm që nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike porse këtë e ka bërë edhe në mënyrë të gabueshme që pastaj ka rezultuar në një aktgjykim të kundërligjshëm. Avokati mbrojtës e thekson se nuk ka asnjë provë të vetme me të cilën vërtetohet se **Y.J.** ka qenë i përfshirë në shitjen e 22 kg drogë të rrezikshme. Ai e thekson se pa marrjen e drejtpërdrejtë në pyetje të të pandehurve të tjerë të cilëve iu referohet dispozitivi i aktgjyimit, të cilët gjykohen në Gjermani dhe derisa të merren në pyetje edhe personat e tjerë, të cilët sipas prokurorisë janë të përfshirë në vepra penale si vepra të kundërligjshme, nuk mund të konsiderohet se gjendja faktike në këtë çështje penale është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë. Pohimet e dëshmitarit A. që F.Z. ka grumbulluar para fillimisht të pranuar nga B.K. për t'iu kaluar pastaj **Y.J.** janë pretendime pa mbulesë dhe nuk mbështeten me asnjë provë të vetme. Nga kjo rezulton se gjendja faktike e vërtetuar përmes dëshmisë së hetuesit A., nuk mbështetet me asnjë fakt dhe se bazohet vetëm në dëshirat e tij si polic për ta parë të akuzuarin **J.** të përfshirë në shitje të drogës, dhe pastaj duke e përshkruar atë si pjesë e grupit kriminal dhe në fund, për ta bërë shef të këtij grupi kriminal.

Avokati mbrojtës e thekson se eksperti i zërit nuk ka arritur të konstatojë përtej çdo dyshimi se zëri në fjalë në të gjitha përgjimet e prezantuara në aktgjykimin e kontestuar, i takon të akuzuarit **J.** Ai pretendon se ekspertiza psikiatrike jo vetëm që është gjysmake dhe e pjesshme por as nuk është vërtetuar në mënyrë shkencore.

Mbrojtja është e mendimit se ky veprim i gjykatës është i kundërligjshëm sepse i akuzuari **J.** është dënuar me dënim maksimal për një vepër penale të cilën nuk e ka kryer dhe përveç kësaj ai ishte dënuar me dy dënime të rënda për një vepër penale. Mbrojtja është e mendimit se aktgjykimi i kundërshtuar është i kundërligjshëm edhe për arsye se nuk është marrë në konsideratë asnjë rrethanë lehtësuese për të akuzuarin **J.** edhe pse të tilla kanë ekzistuar. Vendimi mbi sanksionin penal është i kundërligjshëm edhe për shkak të bashkimit të dënimeve të kryera në bazë të nenit 71 të KPK-së.

**Mbrojtësi Zhivojin Jokanovic** më 10 mars 2014 (e dërguar me postë më 6 mars 2014) me kohë e ka parashtruar ankesën e datës 6 mars 2014 në Gjykatën Themelore për shkak të:

- shkeljes esenciale të procedurës penale të nenit 383, paragrafi 1, pika 1 të KPP-së;
- shkeljes së ligjit penal, neni 383, paragrafi 1, pika 2 e KPP-së;
- vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, neni 383, paragrafi 1, pika 3 të KPP-së;
- vendimit mbi dënimin dhe për këtë arsye propozon që aktgjykimi në pjesën e dënimit të ndryshohet, për të shqiptuar dënim më të butë ndaj të pandehurit ose që i njëjti të priset dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim.

Mbrojtësi Zivojin Jokanovic vë në pah se ai do të paraqes arsyetimin e ankesës në gjykatë me një parashtrësë të ndarë. **Arsyetimin e ankesës të datës 18 shkurt 2014, ai e ka parashtruar më 24 mars 2014.**

Mbrojtja paraqet se aktgjykimi përmban shkelje substanciale të procedurës penale sepse dispozitivi i aktgjykimit nuk e ka bazën në prova të administruara dhe është në kundërshtim me arsyetimin e vet, si edhe nuk përmban arsye për faktet vendimtare. Gjykata e ka bazuar veprimin e kryerjes në prova të paqarta. Vet provat nuk përbëjnë prova të vlefshme dhe të qëndrueshme sepse gjykata e mbivlerëson ekspertizën e zërit kur konsideron se zëri i të pandehurit identifikohet në të gjitha transkriptimet e përmendura gjë e cila nuk përputhet me gjetjet e ekspertit. Gjykata e parashikon por nuk e vlerëson faktin se qindra telefona i janë gjetur të pandehurit por asnjëri nga ata nuk ishte shfrytëzuar për të kontaktuar me bashkëkryerësit e pohuar brenda apo jashtë vendit.

Akuza, e në veçanti, dispozitivi i aktgjykimit nuk kanë bazë në provat e administruara sepse nuk mund të supozohet se i pandehuri ishte koordinator ose që ai, në çfarëdo mënyre, ka luajtur rol të rëndësishëm, bile edhe nën supozimin se ai e ka ditur ose që ka mundur ta ketë ditur se çështja në fjalë ishte trafikim i substancave psikotropike. Është shpërfillur fakti se vet i pandehuri ishte i varur nga droga që prej moshës 13 vjeç.

Gjykata Themelore nuk i pranon drejtpërsëdrejti deklaratat e dëshmitarit si prova në të cilat bazohet aktgjykimi por të njëjtat i shfrytëzon duke i vlerësuar përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve.

## **Përgjigjet në ankesa të datës 11 mars 2013 (2014) dhe 31 mars 2014**

Në përgjigjet e tij në ankesa, prokurori i PSRK-së konsideron se arsyet e pohuara nga mbrojtja janë të pabaza dhe kërkon që të miratohet dënimi i **Y.J.** për të gjitha pikat e aktakuzës. Në kundërshtim me pohimin e mbrojtjes, deklaratat e M.G. dhe M.O. janë shpallur të papranueshme nga trupi gjykues (faqe 26). Prokurori konsideron se kolegji ka bërë lajthim juridik për këtë çështje duke i përjashtuar provat nga shqyrtimi. Prokurori fuqishëm e refuzon argumentin se dëshmia e dëshmitarit T.A. duhet të ishte përjashtuar për faktin e thjeshtë se ai ishte polic i përfshirë në kryerjen e hetimit për krimet e pohuara në këtë çështje. Ai është i mendimit se provat e bazuar në thashetheme janë të pranueshme nëse në mënyrë eksplicite kjo nuk është e ndaluar. Provat e siguruara përmes përgjimit të ligjshëm janë sheshit të pranueshme sipas procedurës penale të Kosovës në të cilën zbatohet vlerësim i lirë i provave.

Prokurori e konteston pohimin e mbrojtjes se krimi i organizuar dhe blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotropike janë një dhe e njëjta vepër në kuptimin se dënimi i të pandehurit për të dy veprat penale supozohet se cenon parimin *ne bis in idem*. Prokurori i konteston pohimet e mbrojtjes lidhur me dënimin mbi sanksionin penal dhe konsideron se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të duhur e ka caktuar dënimin unik për të gjitha pikat e aktakuzës.

Prokurori i konteston pohimet e mbrojtjes lidhur me ekspertizën krahasuese të zërit si të pabaza. Konkluzionet e ekspertit janë shumë të qarta dhe nuk lënë asnjë dyshim të arsyeshëm.

Prokurori kërkon nga Gjykata e Apelit ta konfirmojë dënimin e të pandehurit për të gjitha pikat e aktakuzës dhe ta refuzojë ankesën e mbrojtjes si të pabazuar.

## **Ankesa kundër urdhëresës PKR. nr. 237/13, të datës 6 mars 2014**

Prokurori i propozon Gjykatës së Apelit ta kthej ose ndryshojë urdhëresën në tërësi apo pjesërisht sa i përket shkeljes së procedurës penale mbi këto arsye:

- Lajthim juridik në vërtetimin e dobisë pasurore;
- Vlerësim të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike vetëm sa u përket aseteve të kërkuara për konfiskim të përhershëm.

Prokurori vë në pah se ligji në fuqi parasheh konfiskimin e aseteve të cilat janë fituar jo vetëm si rezultat i drejtpërdrejtë i veprimeve që përbëjnë vepër penale por edhe kur ato janë blerë me fonde të cilat janë fituar nga veprat penale. Për më tepër, gjykata është dashur ta zbatonte nenin 277, paragrafi 1 të KPP-së. Shumat e përmendura monetare në aktgjykim janë ato të cilat përbëjnë dobi të drejtpërdrejtë pasurore për **Y.J.** Prokurori thekson se nga urdhëresa e datës 6 mars 2014 nuk është e qartë se çfarë peshe kolegji i ka dhënë, po që se i ka dhënë një të tillë, ekspertizës financiare dhe dëshmisë së hetuesit financiar A.O.

Prokurori kërkon nga Gjykata e Apelit ta kthej urdhëresën e datës 6 mars 2014 dhe/ose ta ndryshojë urdhëresën në fjalë, ose në tërësi ose pjesërisht, për ta urdhëruar konfiskimin e sendeve; ose çështjen ta kthej tek trupi gjykues në rivendosje me udhëzime të duhura.

### **Përgjigja në ankesë**

Mbrojtësi Ramë Gashi propozon që ankesa e PSRK-së të hedhet poshtë si e vonuar dhe e pabazë, ndërsa të konfirmohet urdhëresa për kthimin e sendeve e datës 6 mars 2014. Ankesa për mos konfiskim të sendeve ka mundur të parashtrohet vetëm duke paraqitur ankesë kundër aktgjykimit. Ai thekson se Gjykata Themelore nuk ka lëshuar aktvendim por thjesht urdhëresë për kthimin e sendeve vetëm pasi që ishte konfirmuar se prokuroria nuk kishte parashtruar ankesë kundër aktgjykimit rreth çështje së mos-konfiskimit të sendeve.

Nga dokumentet e paraqitura, në mënyrë të qartë, është provuar zanafilla e sendeve të marra e edhe fakti se kush është pronari real i sendeve. Ai vëren se vetura “Audi”, stolitë e arit dhe ora “Rolex” nuk ishin pronë e Y.J., nuk ishin blerë nga ai. Të gjitha këto sende ishte pronë e J.J.

### **Propozimi i prokurorit të apelit**

Në propozimin e tij të datës 15 prill 2014, prokurori i apelit Claudio Pala propozon të refuzohet ankesa e mbrojtësit Besnik Berisha kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës si e pabazë dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar; që të hedhet poshtë si e paafatshme ankesa e mbrojtësit Zhivojin Jokanoviq kundër aktgjykimit të Gj/Th të Prishtinës dhe që të pranohet ankesa e prokurorit special kundër urdhëresës së Gj/Th të Prishtinës.

## **III. Gjetjet**

### **Kompetenca e Gjykatës së Apelit**

Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur mbi ankesën, sikurse parashihet me nenin 17 dhe nenin 18 të Ligjit mbi gjykatat (Ligji nr. 03/L-199).

Kolegji i Gjykatës së Apelit është formuar në përputhshmëri me nenin 19 paragrafi (1) të Ligjit mbi gjykatat dhe nenin 3 të Ligjit me numër 03/L-053 mbi kompetencat dhe juridiksionin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

### **Pranueshmëria e ankesave**

(1) Ankesat kundër aktgjykimit

Ankesat janë të pranueshme. Aktgjykimi i kundërshtuar ishte shpallur më 29 nëntor 2013. Aktgjykimi i kundërshtuar i është dorëzuar të pandehurit më 20 shkurt 2014. Aktgjykimi me shkrim i është dorëzuar mbrojtësit Besnik Berisha më 14 shkurt 2014 dhe mbrojtësit Zivojin

Jokanovic më 21 shkurt 2014. Ankesat e të dy mbrojtësve ishin parashtruar brenda afatit të paraparë 15 ditor, sipas nenit 380 (1) të KPP-së dhe nga personi i autorizuar.

Në kundërshtim me pohimin e prokurorisë, edhe ankesa e mbrojtësit Jokanovic ka qenë e parashtruar në kohë. Megjithatë të gjitha informacionet e nevojshme i janë dorëzuar Gjykatës Themelore, sipas nenit 376 të KPP-së, më 24 mars 2014 pra pas skadimit të afatit 15 ditë. Në këtë mënyrë, kolegji nuk e merr parasysh arsyetimin e ankesës dhe i njëjti duhet të refuzohet si pa afat edhe pse ankesa ka qenë e parashtruar në kohë.

Me këtë rast, zbatohet neni 394 (2) i KPP-së. Gjykata e Apelit kufizohet në shqyrtimin e shkeljeve nën paragrafin 1 nën-par 1.1 përmes 1.4 të nenit aktual dhe në shqyrtimin e vendimit mbi dënimin, trajtimin e detyrueshëm rehabilitues dhe konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar nga kryerja e veprës penale.

## (2) Ankesa kundër urdhëresës

Ankesa kundër urdhëresës së lëshuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës ishte parashtruar në kohë nga prokuroria më 6 mars 2014. Në kundërshtim me pohimin e mbrojtësit, ankesa nuk ka qenë pa afat. Urdhëresa është lëshuar më 6 mars 2015. Pra sipas nenit 284, paragrafi 1 dhe 8 të KPP-së, dhe informacionit mbi mjetet juridike të dhëna nga Gjykata Themelore dhe urdhëresën e saj, prokurori ka afat një javë për të parashtruar ankesë. Prokurori e ka parashtruar ankesën më 24 mars dhe duke e bërë këtë ai i ka përmbushur kushtet ligjore të afatit të përmendur më sipër. Ankesa prandaj ka qenë e parashtruar në kohë.

## **Shkelje thelbësore e dispozitave të procedurës penale dhe vërtetim i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike**

Gjendja faktike është vërtetuar gabimisht nga gjykata e shkallës së parë kur nuk mori parasysh dëshmitë e gjashtë dëshmitarëve. Për këtë arsye Gjykata e Apelit nuk i pranon të gjeturat faktike dhe arsyetimin e trupit gjykues.

## Vërejtje të përgjithshme

Si rregull e përgjithshme, rishikimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë lidhur me vërtetimin e fakteve kufizohet nga pohimet e parashtruesit të ankesës. Kjo nuk është çështje të cilën Gjykata e Apelit mund ta shqyrtojë sipas detyrës zyrtare (neni 394.1 i KPP-së *a contrario sensu*). Pala duhet të ofrojë motivim të saktë për ankesë dhe ta sqarojë në mënyrë të qartë cilat prova tregojnë se një fakt i caktuar është dashur të ketë qenë i konsideruar si i provuar ose jo i provuar dhe pse. Ligji nuk ua jep palëve të drejtën e një aktgjykimi të dytë për të njëjtat prova, sikurse ua jep të drejtën për shqyrtimin e mënyrës se si është vërtetuar. Ashtu si ka qenë edhe më parë e vërtetuar

nga Gjykata e Apelit<sup>1</sup>, konditat e “vërtetimit të gabueshëm të gjendjes faktike” dhe “vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike” u referohen gabimeve ose lëshimeve në lidhje me “faktet vendimtare” të cilat janë kyçe për të sjellë një aktgjykim<sup>2</sup>. Vetëm po që se gjykata e shkallës së parë ka bërë një gabim themelor gjatë vlerësimit dhe vërtetimit të fakteve, atëherë Gjykata e Apelit do ta kthejë aktgjykimin<sup>3</sup>.

Marrë në përgjithësi, vlerësimi i provave duhet të mbështetet në shqyrtim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm të dëshmimeve dhe deklaratave verbale nga një kolegji i gjyqtarëve. Leximi i procesverbalit të provave të shqyrtuara në gjykim, sado i besuar dhe i saktë të jetë, gjithmonë është një instrument më pak i besueshëm për vlerësimin e tyre. Bile dhe shqyrtimi i dokumenteve dhe provave të tjera materiale në përgjithësi është më i saktë në gjykim sepse shpesh ndodh që provat duhet të analizohen në lidhje me elementet e tjera dhe janë subjekt i shpjegimeve verbale nga dëshmitarët ose palët. Për këtë arsye, ashtu sikurse është vërtetuar nga kjo gjykatë në raste të tjera<sup>4</sup>, “Është parim i përgjithshëm i procedurës së apelit që Gjykata e Apelit duhet domosdo të ketë një lloj respekti ndaj gjetjeve faktike të trupit gjykues për shkak se ky i fundit ka pasur mundësinë më të mirë për të bërë vlerësimin e provave”.

Gjykata e Apelit ka rishikuar provat e shqyrtuara nga gjykata e shkallës së parë dhe vlerësimin e bërë nga kolegji në aktgjykim. Deklaratat e të pandehurve dhe dëshmitarëve, që të dyja të dhëna në fazën hetimore dhe në shqyrtimin gjyqësor, janë shoshitur nga gjykata e shkallës së parë. I pandehuri ka kundërshtuar aspekte të shumanshme të gjetjeve ligjore dhe faktike dhe arsyetimin e trupit gjykues. Gjykata e Apelit me kujdes i ka shqyrtuar të gjitha këto kundërshtime, ndërsa në lidhje me vlerësimin e provave, në veçanti, kjo gjykatë e thotë këtë:

#### a) Dëshmitë e dëshmitarëve

Gjykata e Apelit konsideron se Gjykata Themelore nuk i ka marrë parasysh të gjitha dëshmitë e dëshmitarëve të propozuar nga mbrojtja. Gjykata Themelore është e obliguar të japë arsyetim në përputhje me ligjin në rast të mosmiratimit të propozimeve konkrete të palëve - neni 370, paragrafi 7 KPP. Mocioni i mbrojtësit Ramë Gashi për të dëgjuar të gjithë njerëzit si dëshmitarë të përfshirë në këtë rast u refuzua, për shkak se ai nuk i ka dhënë emrat e saktë të individëve dhe nuk ka dhënë ndonjë shpjegim të arsyeshëm për atë se çfarë të gjithë ata njerëz do të dëshmojnë dhe do të vërtetojnë në këtë gjykim. Gjykata e Apelit konstaton se emrat e këtyre personave janë të njohur dhe ata janë të shkruar në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar. Ata duhet të thirren për të dëshmuar për ngjarjet e përshkruara në tre paragrafët e parë të dispozitivit. Prandaj, Gjykata e Apelit mendon se ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale - neni 384, paragrafi 1. Nënparagrafi 1.12 në lidhje me nenin 370, paragrafi 7 KPK. Trupi Gjykues

<sup>1</sup> PAKR 1121/12, aktgjykim i datës 25 shtator 2013.

<sup>2</sup> Aktgjykim i përmendur i referohet B. Petric, në: komentimet e neneve të Ligjit Jugosllav mbi Procedurën Penale, botimi i dytë 1986, neni 366, para. 3.

<sup>3</sup> PaKr 1122/12, aktgjykim i datës 25 prill 2013.

<sup>4</sup> PAKR 1121/12, aktgjykim i datës 25 shtator 2013.

konstaton se është i nevojshëm një shqyrtim i ri gjyqësor para Gjykatës Themelore për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale. Në rigjykim, Gjykata Themelore për këtë arsye duhet të japë një afat të arsyeshëm në të cilin mbrojtja e paraqet adresën dhe të dhënat e personave të mëposhtëm:

- a) F.Z.
- b) S.A.
- c) J.B.
- d) S.F.
- e) M.D.
- f) A.M.

Këta persona duhet të thirren për të dëshmuar si dëshmitarë. Pas kësaj, Gjykata Themelore duhet të bëjë një vlerësim të ri të të gjitha provave. Të përmbledhur, por duke mos dëshmuar dëshmitarët e përmendura më sipër, nuk mund të përjashtohet plotësisht se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar ose jo të plotë nga gjykata e shkallës së parë..

b) Dëshmia e dëshmitarit A. dhe deklaratat e M.G. dhe M.O

Në lidhje me dëshminë e dëshmitarit A., kolegji konsideron se provat janë plotësisht të pranueshme. Propozimi i Prokurorit për t'i pranuar si prova të lexuar deklaratat e M.G. dhe M.O. u refuzuar nga Gjykata Themelore.

Mbrojtja ka pohuar se dëshmitë e dhënë nga A. janë pohime pa mbulesë dhe nuk mbështeten me asnjë provë. Më tej, dëshmia e tij bazohet në dëshirën e tij për ta parë të akuzuarin të përfshirë në shitblerjen e drogës. Pra, gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka lejuar dëshmitarin A. të jap dëshmi lidhur me të pandehurin.

Gjykata e Apelit nuk pajtohet me këto argumente. Në kundërshtim me deklaratën e dhënë nga mbrojtja, Gjykata e Apelit nuk ka asnjë shqetësim ligjor me atë se Gjykata Themelore e ka lejuar A. të jep dëshmi për deklaratat e G. dhe O.

Procedurë penale e zbatueshme është ajo në të cilën provat mund të shpallen të papranueshme vetëm *kur ligji shprehimisht parashikon kështu* (neni 257 paragrafi 2 i KPP-së). Në të gjitha rrethanat e tjera, provat do të jenë të pranueshme por cenimi i mundshëm i dispozitave ligjore mund të ketë ndikim në vlerën provuese të provave.

Edhe pse G. dhe O. kanë refuzuar të japin dëshmi në gjykim, A. ka dhënë dëshmi për deklaratat e dhëna nga G. dhe O. Kjo “provë më the-të thashë” në përgjithësi është e pranueshme dhe nuk ndalohet me ligj. Ajo mund të vlerësohet dhe merret parasysh nga gjykata sepse procedura e zbatueshme penale është ajo që përfshin një vlerësim të lirë të provave. Sido që të jetë, Gjykata e Apelit thekson se një asi prove – thashetheme, edhe pse e pranueshme, mund të ketë vlerë

kufizuese dhe nuk duhet t'i jepet e njëjta peshë sikurse dëshmime të dëshmitarëve të cilët ishin më të afërt me incidentin.

Kolegji thekson se nuk ka arsye ligjore pse dëshmia e dëshmitarit A. si provë duhet të jetë e papranueshme. Në këtë aspekt nuk ekziston dispozitë ligjore e cila e ndalon gjykatën për të marrë dëshmi nga një zyrtar policor. Në këtë rast nuk është i zbatueshëm neni 128 paragrafi 1.4. Në këtë kontekst, kolegji refuzon pohimin se policia gjatë zhvillimit të hetimeve po e luan rolin e autoritetit akuzues. Kjo është e gabueshme. Është fakt se policia është autoritet më pak akuzues e më shumë organ i paanshëm për të zbuluar veprat penale, për të zhvilluar hetime dhe për të mbledhur prova për shfrytëzim në procedurën penale. Prandaj Gjykata Themelore nuk ka bërë lajthim juridik kur e ka lejuar policin A., të jap mendimin e tij si provë për çështjet me aq sa ka pasur njohuri dhe përvojë.

#### c) Dokumentacioni mjekësor nga Gjermania

Gjykata e Apelit më tej konsideron se nuk është bërë vërtetimi i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike në lidhje me dokumentacionin mjekësor të marrë në Gjermani. Mbrojtja pati kërkuar që dokumentacioni të pranohet si provë por gjykata e shkallës së parë e kishte refuzuar këtë provë dhe kishte hequr dorë për ta kërkuar dokumentacionin nga Gjermania.

Kolegji pajtohet me Gjykatën Themelore dhe nuk sheh asnjë shkelje të procedurës penale. Nuk është e nevojshme të kërkohet dokumentacioni mjekësor i cili ishte bërë në Gjermani përderisa ekzistojnë ekzaminime të tjera mjekësor të bëra në Kosovë e të cilat mjaftueshëm e përshkruajnë gjendjen mendore të të pandehurit si të mirë. Viteve të fundit, i pandehuri ka qenë në Kosovë, pra është absolutisht e mjaftueshme për të pasur dokumentacionin mjekësor të bërë në Kosovë. Ky dokumentacion e pasqyron më së miri gjendjen e tanishme mendore të të pandehurit. Kolegji prandaj konsideron se Gjykata Themelore nuk ishte dashur ta marr parasysh dokumentacionin nga Gjermania i cili ishte bërë para dokumentacionin mjekësor të kryer në Kosovë. Megjithatë, po që se është e nevojshme për një ekzaminim tjetër mjekësor, atëherë gjithsesi duhet të merren parasysh të gjitha masat për ta siguruar dokumentacionin e duhur.

#### d) Prova e përgjimit

Gjykata e Apelit nuk ka asnjë shqetësim ligjor në lidhje me provën e përgjimit. Mbrojtja konsideron se ekspertiza krahasuese e zërit është e pabazë dhe e kundërshton metodën shkencore dhe konkluzionin e ekspertit.

Sa i përket ekspertit të zërit, kolegji konsideron se caktimi i ekspertit si edhe shqyrtimi i përgjimeve janë bërë në mënyrë të drejtë dhe të duhur. Eksperti i zërit ishte caktuar siç duhet nga gjykata, pa kundërshtim të mbrojtjes në kohën e njoftimit. Përveç kësaj eksperti e ka përgatitur siç duhet raportin mbi ekzaminimin e krahasimit të zërit me shpjegim të qartë dhe të plotë të mjeteve dhe metodave të përdoruara dhe materialeve të gjetura e të nxjerra. Raporti është

tërësisht në përputhje me kushtet e parapara nga neni 138 i KPPK-së, e në mënyrë specifike ai përmban (1) identitetin e ekspertit dhe procedurën, (2) çështjen e rëndësishme rreth fajësisë ose pafajësisë të të pandehurit, (3) trajnimin dhe përvojën e specializuar të ekspertit dhe (4) përshkrimin e analizës, përfshirë fotografi përkatëse, skica përmbledhëse, pamje, rezultatet e laboratorit ose informacione të tjera përkatëse shkencore apo teknike (5) shpjegimin se praktikrat teknike janë në përgjithësi të pranueshme brenda fushës së ekspertit ose kanë bazë shkencore ose teknike, dhe (6) konkluzionin me mendimin e ekspertit.

Në përgjithësi nuk ka shkelje të dispozitave rreth caktimit të ekspertit të zërit ose vlerësimit të tij për përgjimet. Provat dokumentuese dhe të mjekësisë ligjore kanë qenë të vlerësuara me kujdes. Eksperti në tetë raste, në mënyrë të qartë, e ka identifikuar zërin e të akuzuarit dhe e ka shpjeguar shumë mirë se për cilat arsye zëri i identifikuar është i të akuzuarit. Aktgjykimi e sqaron në hollësi kuptimin e asaj prove dhe kundërthëniet në mes tyre. Aktgjykimi e sqaron këtë në mënyrë bindëse e cila e shtyn kolegjin e apelit të pranojë se të gjeturat faktike në aktgjykim, në këtë pikë, janë një shpjegim i arsyeshëm, logjik dhe i mundshëm për provat.

### **Cenimi i parimit të paanshëm dhe barazia e armëve**

Në kuadër të kësaj që u tha më sipër, Gjykata e Apelit vëren cenimin e parimit të barazisë së armëve.

Sipas GjEDNj-së, parimi i barazisë së armëve është pjesë e konceptit më të gjerë për një gjykim të drejtë.<sup>5</sup> Ai është i lidhur ngushtë me të drejtën në procedurë kundërshtuese e cila nënkupton se palët e përfshira në gjykim kanë mundësinë për të pasur ‘njohuri dhe të komentojnë për të gjitha provat e paraqitura ose vërejtjet e parashtruara’. Parimi ka një fushëveprim të gjerë dhe është i zbatueshëm gjatë të gjitha fazave të procedurës penale, madje edhe gjatë hetimeve preliminare të policisë. Përveç kësaj, parimi kërkon ‘që përveç argumenteve të prokurorisë, të dëgjohen sa më shumë që të jetë e mundshme edhe argumentet e mbrojtjes’ por kjo nuk kërkon në mënyrë të domosdoshme që një “padrejtësi sasiore të rrjedh nga një pabarazi procedurale”.

Në përputhje me rrethanat, TPNJ konsideron se ky parim kërkon që të dy palët të kenë mundësi të arsyeshme për ta paraqitur rastin e tyre nën kushtet të cilat nuk do ta vënin asnjërin nga to në pozicion më të pafavorshëm se tjetra.<sup>6</sup> Të drejtat e mbrojtjes dhe barazia e armëve janë tipare të konceptit më të gjerë të një gjykimi të drejtë. Kjo kërkon një “ekuilibër të drejtë në mes të palëve”. E njëjta kërkon që secilës palë në procedurë t’i jepet një mundësi e arsyeshme për ta paraqitur rastin e vet nën kushtet të cilat nuk e vejnë atë në situatë konsiderueshëm të pafavorshme në raport me kundërshtarin e tij.

---

<sup>5</sup> Shih GjEDNj, *Delcourt v. Belgjikës* (kërkesa me numër 2689/65), 17 janar 1970, § 28. Gjykata ka qenë po ashtu e mendimit këtu se ‘gjykimi nuk do të ishte i drejtë po që se do të zhvillohej në kushte të tilla që do ta vënin të akuzuarin padrejtësisht në situatë të pafavorshme.’ Shih po aty, § 34. Gjithashtu GjEDNj, *Borgers v. Belgjikës* (kërkesa me numër 12005/86), 30 tetor 1991, (procureur general), §§ 24 dhe 26.

<sup>6</sup> Shih, për shembull, TPNJ: Vendimi për ankesën e prokurorit, *Aleksovski*, supra note 1, § 24.

Parimi i barazisë së armëve ka qenë i miratuar në nenet 328-356 të KPP-së. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, prokurori, pala e dëmtuar dhe i pandehuri kanë të drejta të barabarta për të dhënë deklaratë të hapur, për t'i thirrur dhe për tu përballur me dëshmitarët, për të paraqitur prova dhe për të dhënë fjalën përfundimtare.

Mbrojtja ka pohuar për shkelje të parimit të barazisë së armëve sepse përderisa gjykata e shkallës së parë e ka lejuar dhe i ka besuar plotësisht deklaratën e hetuesit policor A., nga ana tjetër ajo e ka refuzuar propozimin e mbrojtjes për ta dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit avokatin i cili kishte marrë pjesë në procedurën penale kundër G. dhe O.

Gjykata e Apelit nuk e konsideron shkelje të parimit të gjykimit të drejtë dhe të barazisë së armëve kur trupi gjykues ka refuzuar që avokati të dëshmojë si dëshmitar. Në gjykim, avokati nuk është palë në procedurë penale. Megjithatë ai është përfaqësues i interesit të të pandehurit dhe dëshmia e tij nuk ka fare ose ka vlerë shumë të kufizuar. Pra në këtë aspekt, nuk mund të akuzohet se trupi gjykues nuk e ka marrë në pyetje atë.

Sido që të jetë, kolegji ka vënë në pah se, mos dëshmimi i gjashtë dëshmitarëve të përmendur më sipër (F.Z.; S.A.; J.B.; S.F.; M.D.; A.M.) sikurse është propozuar nga mbrojtja, ka cenuar njëherazi edhe parimin e një gjykimi të drejtë edhe barazinë e armëve për shkak se të drejtat e të pandehurit nuk janë marrë në masë të duhur në konsideratë.

### **Shkeljet e pohuara të kodit penal**

Gjykata e Apelit konsideron se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka zbatuar kodin penal kur e ka e ka shpallur të pandehurin fajtor. Për këtë arsye dispozitivi duhet të ndryshohet. Duhet të qartësohet se i pandehuri e ka kryer një vepër penale, në vend të dy veprave të ndara penale.

Gjykata Themelore e ka shpallur të pandehurin fajtor për veprën penale të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike, në kundërshtim me nenin 229 paragrafët 1, 2, 3 të KPK-së dhe ai u dënua me gjashtë (6) vjet burgim. Më tej ai u shpall fajtor për veprën penale të krimit të organizuar, në kundërshtim me nenin 274, par. 3 të KPK-së dhe u dënua me tetë (8) vjet burgim dhe gjobë në shumën prej 25,000 euro. Në përputhje me nenin 71 të KPK-së, Gjykata Themelore ka shqiptuar dënimin unik prej njëmbëdhjetë (11) vjet burgim dhe gjobë në shumën prej 25,000 euro.

Gjykata e Apelit vë në pah se i pandehuri nuk mund të dënohet për dy vepra të ndryshme penale. Në këtë drejtim kolegji u referohet vendimeve të mëparshme të Gjykatës Supreme /Gjykatës së Apelit të cilat konfirmojnë se “krimi i organizuar” është vepër cilësues dhe për këtë arsye kurrë nuk mund të merret si vepër e ndarë penale. Gjykatat në vazhdimësi kanë qenë të mendimit se *për vepër të njëjtë penale* i pandehuri nuk mund të dënohet edhe për (i) krim të organizuar, sipas nenit 274 (1) të KPK-së, **edhe** për (ii) krim bazë të rëndë i kërkuar si element i veprës penale. Po qe se do të kishte qasje tjetër, i pandehuri do të dënohej dy herë për të njëjtën vepër. Gjykata Supreme e Kosovës e ka theksuar në një aktgjykim të saj të mëparshëm se vepra e krimit të organizuar kërkon kryerjen e një vepre ‘bazë’ penale, përveç veprës penale të krimit të

organizuar, sipas nenit 274 të KPK-së. Formulimi i përdorur përgjatë nenit 274 të KPK-së në mënyrë të qartë parasheh se kryerja e veprës bazë penale është element përbërës i kësaj veprë. Përndryshe, një individ do të mundë të shpallej fajtor për të njëjtën veprë, pjesë përbërëse e të dy veprave penale, të krimit të organizuar dhe të veprës bazë penale. Kjo gjendje mund të përbëjë shkelje për ta ndaluar shqiptimin e dënimit të dyfishtë për një veprë të vetme penale.<sup>7</sup> Gjykata e Apelit pajtohet me interpretimin e mësipërm të Gjykatës Supreme dhe konsideron se kjo e bën të domosdoshëm modifikimin e aktgjykimit të kundërshtuar. Në lëndën në fjalë, vepra penale e krimit të organizuar e konsumon veprën penale të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike si veprë ‘bazë’ penal të saj.

**I pandehuri, në të vërtetë, mund të shpallej fajtor për veprën penale të krimit të organizuar në lidhje me blerjen, posedimin, shpërndarjen dhe shitjen e paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike e kryer në vazhdimësi.**

### **Vendimi mbi dënimin**

Gjykata e Apelit konsideron se rrethanat lehtësuese dhe rënduese nuk janë përshkruar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme në arsyetimin e aktgjykimit. Llogaritja e dënimit është bërë gabimisht sepse rrethanat rënduese dhe lehtësuese nuk janë marrë parasysh në masë të duhur.

Kur të vendoset mbi dënimin dhe llogaritjen e tij, trupi gjykues ka për obligim sipas nenit 74 të KPP-së, që t'i marrë dhe arsyetojë ndaras dhe në tërësi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat kanë ndikim në llojin dhe rëndësinë e dënimit.

Në ankesën e tij, mbrojtësi Berisha vëren se dënimi është shumë i rëndë dhe si i tillë është i kundërligjshëm sepse rëndësia e dënimit nuk është në përputhje me rrezikun publik të veprës penale dhe në veçanti me përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe rrethanat e tij personale e as me rregulloret e dënimeve në sistemin juridik të Kosovës. Ai është i mendimit se aktgjykimi i kundërshtuar është i kundërligjshëm sepse nuk janë marrë në konsideratë rrethanat lehtësuese për të akuzuarin edhe pse të njëjtat kanë ekzistuar. Në këtë drejtim, gjykatat e Kosovës zakonisht i marrin në konsideratë në favor të të akuzuarit këto rrethana: moshën e atë akuzuarit, rrethanat personale, sjellja e tij gjatë dhe pas kryerjes së veprës penale, gjendjen familjare dhe ekonomike ose faktin se nuk ishte dënuar më parë. Pasi që gjykata, në veçanti, i ka injoruar faktet se dënim i mëparshëm nuk ka qenë i vërtetuar në Kosovë dhe se vet i pandehuri ka qenë në varësi të drogës që nga moshja 13 vjeç, dënimi është i kundërligjshëm me shpërfilljen e rrethanave lehtësuese.

Kur e ka llogaritur dënimin, Gjykata Themelore e ka bazuar vendimin kryesisht në motivet e të pandehurit të cilat, gjatë kryerjes së veprës penale, kanë qenë tërësisht spekulative. Për më tepër, gjykata pohon se i pandehuri për pothuajse dy vjet i ka vazhduar aktivitetet e veta kriminale duke e ditur efektin helmues dhe të varësisë së narkotikëve në trupin e vet. Ai qëllimisht i ka

---

<sup>7</sup> Shih aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në lëndën me numër Ap-Kz 61/2012 të datës 2 tetor 2012, para 48.

shpërndarë drogat narkotike dhe duke e bërë këtë ai ka shkaktuar probleme të rënda shëndetësore, sociale dhe ekonomike.

Gjykata e Apelit nuk pajtohet me mbrojtjen se varësia nga droga e të pandehurit duhet të shihet si fakt lehtësues. I pandehuri, dhe në këtë pikë kolegji pajtohet me Gjykatën Themelore, ishte në dijeni të efektit të varësisë dhe helmimit nga droga por pavarësisht kësaj dhe me këtë vetëdije që kishte ai e ka trafikuar për një kohë të gjatë. Motivimi i tij kryesisht udhëhiqej nga qëllimi për të përfituar në mënyrë që ta ruaj stilin e tij shumë të pasur të jetesës.

Megjithatë Gjykata e Apelit konsideron se trupi gjykues nuk i ka marrë sa duhet parasysh çështjet e ngritura në nenin 74 të KPK-së dhe për këtë arsye nuk pajtohet plotësisht me gjetjet e saj për rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Dënimi i shqiptuar nuk është sa duhet i arsyeshëm dhe proporcional; një dënim i këtillë nuk korrespondon plotësisht me shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikut. Si i tillë dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë nuk është proporcional me veprën penale duke e bërë kështu atë të papranueshëm për Gjykatën e Apelit.

Në kuadër të kësaj që u tha më sipër, Gjykata Themelore është dashur, për këtë arsye, të jap arsyetim të mjaftueshëm për të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

### **Urdhëresa e Gjykatës Themelore lidhur me sendet e konfiskuara**

Ankesa e parashtruar nga prokuroria është e bazuar.

Kolegji nuk është i kënaqur me gjetjet e gjykatës së shkallës së parë. Lidhur me veturën Audi A6 dhe gjësendet e tjera të konfiskuara, trupi gjykues duhet ta caktojë një ekspert që në mënyrë të saktë do t'i vlerësojë dhe përcaktojë të ardhurat e ligjshme të të pandehurit, të familjes dhe prindërve të tij. Për më tepër, eksperti duhet ta vlerësojë sa çfarë shumë të parave të ligjshme ka pasur në dispozicion i pandehuri për ta blerë veturën dhe sendet e tjera të konfiskuara.

Kolegji thekson se i pandehuri më tej duhet të sjellë prova se automjeti si edhe sendet e konfiskuara u takojnë prindërve/familjes së tij. Pra trupi gjykues duhet ta shqiptojë detyrimin ndaj të pandehurit për të ofruar dokumentacionin e duhur si provë.

Kolegji vëren se edhe pronësia e shtëpisë, banesës, duhet të qartësohet në mënyrë që të merret një pasqyrë e qartë e pronës së të pandehurit dhe familjes së tij. Pas marrjes së një imazhi të qartë, atëherë mund të vërtetohet nëse vetura Audi A6, stolitë e çmuara, 15 telefonat celular, lloptopi, orë Rolex dhe paratë e konfiskuara gjatë bastisjes më 2 dhjetor 2012, ashtu sikurse përmenden në aktakuzë, kanë qenë të blera nga të ardhurat e ligjshme ose të paligjshme.

### **Vërejtje përfundimtare**

Kolegji nxjerr përfundimin se një shqyrtim i ri gjyqësor i Gjykatës Themelore është i domosdoshëm për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Prandaj Gjykata e Apelit nuk mund të vazhdojë tutje

me nenin 403 të KPP-së. Aktgjykimi dhe urdhëresa duhet të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim në Gjykatën Themelore.

I pandehuri mbetet në paraburgim derisa Gjykata Themelore të marrë vendimin e radhës. Në rigjykim, Gjykata Themelore duhet të vendos për paraburgimin sipas nenit 193 të KPP-së.

*Nga kjo që u tha më sipër, u vendos si në dispozitivin e aktvendimit të tanishëm.*

---

*Aktvendimi i arsyetuar me shkrim është kryer më 24 qershor 2015.*

Kryetari i kolegjit

---

Radostin Petrov  
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtari i kolegjit

---

Driton Muharremi  
Gjyqtar kosovar

Anëtarja e kolegjit

---

Tonka Berishaj  
Gjyqtare kosovare

Procesmbajtësi

---

Bernd Franke  
Zyrtar ligjor i EULEX-it

---

**Gjykata e Apelit**  
Prishtinë

**PAKR 215/14**

**14 maj 2015**

faqe 17 nga 17